



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Prishtinë, 10 dhjetor 2022

REAGIM PUBLIK

Dje, me datë 09 dhjetor 2022 jemi vënë në dijeni se në vendin e tij të punës dhe lidhur me veprimtarinë mjekësore është kanosur anëtari jonë, Dr. Shaqir Uka. Kanosja ndaj anëtarit tonë është drejtuar nga përcjellësit e pacientit i cili është i hospitalizuar në Klinikën e Anestezionit dhe Mjekimit Intensiv Qendror të QKUK-së. Vepra e tillë penale është kryer në segmentin më të ndjeshëm të zingjirit të klinikave të QKUK-së, institucionin në të cilin ndjeshmëria për jetën dhe përgjegjësia për vdekjen është në nivelin më të lartë të mundshëm nga aspekti ligjor dhe i etikës dhe deontologjisë mjekësore.

Oda e Mjekëve të Kosovës duke shprehur idinjatën, brengën dhe solidaritetin me secilin mjek i cili po bëhet cak i sulmeve dhe subjekt i veprës penale, duke shprehur po ashtu kërkesën dhe thirrjen që sulmet ndaj mjekëve për dhe në vendin e punës mos të mbesin vetëm në reagime të përsëritura, i bëjmë thirrje organeve të ndjekjes dhe atyre ligjzbatuese që me efikasitetin maksimal të angazhohen në ndjekjen dhe procedimin e kryersëve të veprave penale. Po ashtu, i bëjmë thirrje Ministrisë së Shëndetësisë që me sponzorizimin e saj të përgatitë rregullativën nënligjore me të cilën do të rregullohej prania e përcjellësve të pacientëve e po ashtu edhe mënyra e kontaktit me mjekët e rastit dhe personelin tjetër shëndetësor.

Është e patolerueshme që komuniteti mjekësor krahas përballjes me kushte të rënda në vendin e punës, qoftë nga aspekti objektiv ashtu edhe nga aspekti socio-ekonomik, ta kenë në barrë frikën, shtrëngimin dhe sulmin fizik. Ne nuk duhet ta lejojmë që rastet e tilla të mbesin vetëm në nivel të reagimeve dhe të komunikatave për informim, por që rastet e tilla të trajtohen në nivel institucional dhe ligjor, duke mos lejuar që ato të transformohen në fenomene normale shoqërore.

Prishtinë, 10.12.2022